# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 01/48**
**Datë: 15.12.2021**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 dhjetor 2021, merr këtë:

## V E N D I M

1. Në nën-programin "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, organizata buxhetore Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, mjetet e buxhetura nga burimi i financimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (kodi 24), në vlerë prej 18,000,000 € (tetëmbëdhjetë milionë euro), kategoria e shpenzimeve "Rezervat", reduktohen në zero euro për shkak të mospranimit të fondeve të planifikuara nga ky burim financimi.

2. Në nën-programin "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, organizata buxhetore Ministria e Finanave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, mjetet e buxhetuara nga burimi i financimit Granti Qeveritar (kodi 10), në vlerë prej 132,373,967 € (njëqindetridhjetë e dy milionë e treqindeshtatëdhjetë e tremijë e nëntëqindegjashtëdhjeteshtatë euro) kategoria e shpenzimeve "Subvencionet dhe Transferet", rritet në 150,373,967 € (njëqindepesëdhjetë milionë e treqindeshtatëdhjetë e tremijë e nëntëqindegjashtëdhjeteshtatë euro), për shkak të pranimit të fondeve shtesë nga ky burim financimi.

3. Lëvizjet në pikën 1. dhe 2. të këtij Vendimi janë neutrale në raport me ndarjen totale te Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike me kod 29300.

4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

Fondet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, të planifikuara në Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike, si burim i financimit përmes Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-016, nuk janë pranuar në Llogarinë e Vetme të Thesarit dhe për rrjedhojë të njëjtat nuk kanë mundur të ndahen dhe alokohen për shpenzim.

Me qëllim që mjetet e planifikuara në PRE të mund të jenë në dispozicion për ndarje dhe alokim, lëvizjet buxhetore të reflektuara në vendim janë evidentuar të domosdoshme dhe

neutrale në raport me kufirin e lejuar të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, nenit 30 të LMFPP, si dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-016.

Rrjedhimisht, duke marrë për ëbazë konstatimet e mësipërme, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/48
Datë: 15.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 16, paragrafit 3. të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 dhjetor 2021, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje buxhetore në kategoritë e shpenzimeve, sipas tabelave të bashkëngjitura në Aneksin A (Kursimet), dhe Aneksin B (Ndarjet).

2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe organizatat buxhetore për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi në momentin e publikimit në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Anex B (Ndarjet)

| BLLOKU_KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | KAT | KATEGORIA | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| 10/208/98100/30/10572/0922 | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DI | INVESTIMET KAPITALE NË ARSIM PARA UNIVERSITAR | 10572 | NDERTIMI I OBJEKTIT TE SHKOLLES | 200,000.00 |
| 10/208/98100/30/18340/0950 | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DI | INVESTIMET KAPITALE NË ARSIM PARA UNIVERSITAR | 18340 | BLERJA E PAKOVE TE PAJISJEVE TE I | 130,000.00 |
| 10/208/98100/30/18476/0912 | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DI | INVESTIMET KAPITALE NË ARSIM PARA UNIVERSITAR | 18476 | NDËRTIMI I SHKOLLËS FILLORE NË K | 100,000.00 |
| 10/208/98100/30/18778/0912 | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DI | INVESTIMET KAPITALE NË ARSIM PARA UNIVERSITAR | 18778 | NDERTIMI I SHKOLLES FILLORE MES | 100,000.00 |
| 10/208/98100/30/14781/0922 | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DI | INVESTIMET KAPITALE NË ARSIM PARA UNIVERSITAR | 14781 | PËRFUNDIMI I SHKOLLAVE NË NDËI | 224,462.00 |
| 10/208/98100/30/18032/0922 | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DI | INVESTIMET KAPITALE NË ARSIM PARA UNIVERSITAR | 18032 | RREGULLIMI I INFRASTRUKTURES P | 147,000.00 |
| 10/208/97400/30/14027/0941 | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DI | UNIVERSITETI I PEJËS | 14027 | NDERTIMI DHE RENOVIMI I INFRAS | 340,500.00 |
| 10/208/98400/30/15120/0941 | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DI | UNIVERSITETI I FERIZAJIT | 15120 | NGRITJA E INFRASTRUKTURES DHE | 150,000.00 |
| Total Ndarjet MASHT | | | | | 1,391,962.00 |

| BLLOKU_KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | PROJ | PROJEKTI | Ndarja |
|---|---|---|---|---|---|
| 10/205/41500/13/00000/0451 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Departamenti i Infrastrukturës Rrugore -Mirembajtja e Autostradave | | Mallra dhe Sherbime | 42,393.96 |
| 10/205/50100/30/18499/0560 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Mjedisi | 18499 | Rikualifikimi i hapesires publike- sh | 105,001.00 |
| 10/205/41800/30/15435/0451 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Rehabilitimi i Rrugëve | 15435 | Riparimi i rrugës rajonale R115 Priz | 542,676.00 |
| 10/205/41800/30/15661/0443 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Rehabilitimi i Rrugëve | 15661 | Riparimi i rrugës rajonale Istog-Pej | 414,324.00 |
| 10/205/42000/30/15290/0443 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Projektet e Bashkfinancimit me Kuvendet Komunale | 15290 | Asfaltimi i rruges Pleshine-Kashtan | 210,790.00 |
| 10/205/42000/30/18175/0443 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Projektet e Bashkfinancimit me Kuvendet Komunale | 18175 | Ndertimi i Rrugës Qendrore ne Deç | 244,018.00 |
| 10/205/42100/30/14706/0443 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Ndërtimet e reja të Rrugëve | 14706 | Ndertimi i nenkalimit per automjet | 433,117.00 |
| 10/205/42100/30/18442/0451 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Ndërtimet e reja të Rrugëve | 18442 | Rregullimi dhe zgjerimi i rruges Planje-Marzrek-Liken i Hasit Ramja e Deshmoreve | 291,765.00 |
| 10/205/45900/30/15095/0160 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Departamenti i Transportit Tokësor | 15095 | Ndertimi i Vendendaljeve te Autob | 980,326.00 |
| 10/205/41600/30/13004/0443 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Mirëmbajtja e Rrugëve | 13004 | Mirembajtja Investive e rrugeve | 400,000.00 |
| 10/205/41800/30/15076/0443 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Rehabilitimi i Rrugëve | 15076 | Rehabilitimi i rruges Doganaj-Shtër | 300,000.00 |
| 10/205/42000/30/18424/0451 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Projektet e Bashkfinancimit me Kuvendet Komunale | 18424 | Rruga në Bjeshken e Strellcit, Deça | 250,000.00 |
| 10/205/42000/30/18725/0443 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Projektet e Bashkfinancimit me Kuvendet Komunale | 18725 | Ndërtimi I rrugës Maja e Zezë - Rrethi I Vitomericës | 100,000.00 |
| 10/205/42100/30/14702/0443 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Ndërtimet e reja të Rrugëve | 14702 | Ndertimi i rruges Viti-Kërbliq-Kaqanik | 130,970.00 |
| 10/205/42100/30/14703/0443 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Ndërtimet e reja të Rrugëve | 14703 | Asfaltimi i rruges Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë | 262,375.00 |
| 10/205/42000/30/15352/0451 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Projektet e Bashkfinancimit me Kuvendet Komunale | 15352 | Asfaltimi I rregeve ne fsh.Pozhar- L | 374,000.00 |
| 10/205/42000/30/15368/0451 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Projektet e Bashkfinancimit me Kuvendet Komunale | 15368 | Asfaltimi i rrugës Mazrek-Xhonaj Bi | 350,000.00 |
| 10/205/42000/30/18393/0451 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Projektet e Bashkfinancimit me Kuvendet Komunale | 18393 | Asafaltimi i rrugës për Bjeshkë Lubo | 417,000.00 |
| 10/205/60800/30/18744/0560 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | Autoriteti Rajonal I Pellgjeve Lumore | 18744 | Regullimi i shtratit te lumit Sitnica V | 200,000.00 |
| 10/205/60500/30/13130/0133 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe In | Zyra per Shpronësim | 13130 | SHPRONESIMET | 6,000,000.00 |
| Total Ndarjet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | | | | | 12,048,755.96 |

| BLLOKU_KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | PROJ | PROJEKTI | Ndarja |
|---|---|---|---|---|---|
| 10/253/27900/30/14652/0820 | AGJENCIA PER MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE ME | AGJENCIA PER MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE | 14652 | Kompleksi Memorial " Shtabi i Per | 46,600.00 |
| 10/253/27900/30/14649/0820 | AGJENCIA PER MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE ME | AGJENCIA PER MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE | 14649 | Kompleksi Memorial ZIV "Shtabi i P | 11,000.00 |
| Total Ndarjet AMKM | | | | | 57,600.00 |

| BLLOKU_KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | PROJ | PROJEKTI | Ndarja |
|---|---|---|---|---|---|
| 10/207/80200/30/13454/0810 | MINISTRIA E KULTURES, RINISE DHE SPORTIT | ARRITJET SPORTIVE | 13454 | PALESTRA SPORTIVE VITI | 200,000.00 |
| 10/207/80200/30/14163/0810 | MINISTRIA E KULTURES, RINISE DHE SPORTIT | ARRITJET SPORTIVE | 14163 | NDERTIMI I PALESTRES SPORTIVE N | 100,000.00 |
| 10/207/80200/30/18686/0810 | MINISTRIA E KULTURES, RINISE DHE SPORTIT | ARRITJET SPORTIVE | 18686 | RIVITALIZIMI I STADIUMIT NË POZH | 260,000.00 |
| 10/207/80300/30/18323/0820 | MINISTRIA E KULTURES, RINISE DHE SPORTIT | PERKRAHJA INSTITUCIONALE PER KULTURE | 18323 | QENDRA KULTURORE-RINORE NË H | 370,000.00 |
| 10/207/80700/30/18373/0820 | MINISTRIA E KULTURES, RINISE DHE SPORTIT | ZHVILLIMI DHE PERKRAHJA E RINISE | 18373 | QENDRA MULTIFUNKSIONALE NË F | 279,965.30 |
| 10/207/81500/30/12688/0820 | MINISTRIA E KULTURES, RINISE DHE SPORTIT | MBROJTJA, RUAJTJA E TRASHEGIMISE KULTURORE | 12688 | MASAT PREVENTIVE, INTERVENIME | 199,000.00 |
| Total Ndarjet MKRS | | | | | 1,408,965.30 |

| BLLOKU_KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | PROJ | PROJEKTI | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| 10/214/30400/30/30041/0310 | MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME | SHËRBIMET E MBËSHTETJES | 30041 | PAISJET POLICORE-LOGJISTIKE | 393,751.00 |
| 10/214/30400/30/30046/0310 | MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME | SHËRBIMET E MBËSHTETJES | 30046 | PAISJE TE TI | 204,000.00 |
| Total Ndarjet MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME | | | | | 597,751.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 10/217/36000/30/18781/0210 | Ministria e Mbrojtjes | FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS | 18781 | SISTEMET E ARMATIMIT | 21,000,000.00 |
| Total Ndarjet MINISTRIA E MBROJTJES | | | | | 21,000,000.00 |
| **Total Shuma për Ndarje** | | | | | **36,505,034.26** |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/48
Datë: 15.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 dhjetor 2021, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, KOSTT (Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.A.) dhe KfW për Projektin "Zhvillimi i Sektorit të Energjisë VII – Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit".

2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë